



Agjencia Kombëtare e
Kontrollit të Cannabis-it

Raport Vjetor

2025

RAPORTI VJETOR 2025

AGJENCIA KOMBËTARE E KONTROLLIT TË CANNABIS-IT

Ky raport vjetor paraqet punën, arritjet, sfidat dhe zhvillimet institucionale të Agjencisë Kombëtare të Kontrollit të Cannabis-it gjatë vitit 2025. Raporti synon të ofrojë një pasqyrë të qartë dhe transparente mbi ushtrimin e misionit të Agjencisë, kontributin në përgatitjen dhe zbatimin e kuadrit rregullator, forcimin e bashkëpunimit ndërinstitutional dhe ndërkombëtar, si dhe rritjen e kapaciteteve teknike dhe profesionale.

Viti 2025 shënon një fazë të rëndësishme të zhvillimit institucional të Agjencisë, ku ngritja dhe funksionalizimi i strukturave, përgatitja e proceseve të licencimit, vendosja e linjave të bashkëpunimit, si dhe zhvillimi i mekanizmave të kontrollit dhe mbikëqyrjes kanë qenë në fokus të veprimtarisë së saj. Ky dokument pasqyron progresin e arritur në raport me objektivat strategjike të miratuar dhe përcakton drejtimit kryesore të punës për vitin pasardhës.

© 2025

AGJENCIA KOMBËTARE E KONTROLLIT TË CANNABIS-IT

Për çdo informacion të mëtejshëm, ju lutemi na kontaktoni.

Adresa: Rruga "Ibrahim Rugova", Godina Sky Tower, Tiranë, Shqipëri

E-mail: info@nacc.gov.al

Website: www.nacc.gov.al

AGJENCIA KOMBËTARE E KONTROLLIT TË CANNABIS-IT

Përmbajtja

Mesazhi i Drejtorit të Përgjithshëm.....	4
Misioni dhe funksionet e Agjencisë	5
Kapitulli 1.....	7
ZBATIMI I KUADRIT LIGJOR DHE RREGULLATOR	7
1.1 Hartimi i akteve nënligjore	7
1.2 Zhvillimi i metodologjive të monitorimit	9
Kapitulli 2.....	11
PROCESI I LICENCIMIT, LEJIMIT DHE MBIKËQYRJES	11
2.1 Kuadri ligjor.....	11
2.2 Mekanizmi i mbikëqyrjes së subjekteve	11
2.3 Standardizimi i formularëve dhe dokumenteve	12
Kapitulli 3.....	13
BURIMET NJERËZORE DHE VERIFIKIMI I PASTËRTISË SË FIGURËS	13
3.1 Plotësimi i strukturës organizative të Agjencisë.....	13
3.2 Verifikimi i pastërtisë së figurës	13
3.3 Trajnimet dhe ngritja e kapaciteteve	14
3.4 Barazia gjinore dhe mbrojtja e integritetit në vendin e punës	15
Kapitulli 4.....	16
BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL	16
4.1 Bashkëpunimi me ministritë përgjegjëse.....	16
4.2 Bashkëpunimi me institucionet ligjzbatuese.....	16
4.3 Bashkëpunimi me universitetet.....	18
4.4 Projekte.....	19
Kapitulli 5.....	20
BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR.....	20
5.1 Aktiviteti i Agjencisë në kuadër të anëtarësimit në CANNRA	20
5.2 Marrëdhëniet me organizata ndërkombëtare.....	21
5.3 Marrëdhëniet me Delegacionin e Bashkimit European në Shqipëri	22
Kapitulli 6.....	22
MENAXHIMI FINANCIAR, PROKURIMI PUBLIK DHE KONTROLLI I BRENDSHËM.....	22
6.1 Procedurat e Prokurimit Publik.....	22
6.2 Menaxhimi financiar dhe kontrolli.....	23

Kapitulli 7.....	23
KOMUNIKIMI DHE TRANSPARENCA ME PUBLIKUN.....	23
7.1 Platformat zyrtare të komunikimit dhe informimit publik	23
7.2 Komunikimi me publikun	24
Kapitulli 8.....	24
OBJEKTIVAT PËR VITIN 2026	24
8.1 Zbatimi i kuadrit ligjor dhe rregullator.....	24
8.2 Procesi i licencimit, lejimit dhe mbikëqyrjes.....	25
8.3 Burimet njerëzore dhe verifikimi i pastërtisë së figurës.....	25
8.4 Bashkëpunimi ndërinstitucional.....	25
8.5 Bashkëpunimi ndërkombëtar	26
8.6 Kërkimi shkencor dhe inovacioni.....	26
8.7 Komunikimi dhe transparenca me publikun	26

Mesazhi i Drejtorit të Përgjithshëm

Ky raport paraqet një pasqyrë të zhvillimit të Agjencisë Kombëtare të Kontrollit të *Cannabis*-it (në vijim Agjencia) gjatë vitit 2025, duke evidentuar hapat e ndërmarrë, sfidat e hasura dhe progresin e realizuar në një sektor të ri dhe kompleks për vendin tonë.

Agjencia u krijua në bazë të ligjit nr. 61/2023, “Për kontrollin e kultivimit dhe përpunimit të bimës së *cannabis*-it dhe prodhimit të nënprodukteve të saj për qëllime mjekësore dhe industriale”, në kuadër të një qasjeje të re dhe të kontrolluar të Shqipërisë ndaj kultivimit dhe përpunimit të *cannabis*-it për qëllime mjekësore dhe industriale. Që nga fillimi, fokusi ka qenë ndërtimi i një strukture funksionale dhe profesionale, e mbështetur në parimet e ligjshmërisë, transparencës dhe bashkëpunimit institucional.

Viti 2025 shënon vitin e dytë të funksionimit të Agjencisë. Gjatë kësaj periudhe, prioritet ka qenë konsolidimi institucional dhe forcimi i kapaciteteve njerëzore, përmes proceseve të rekrutimit dhe zhvillimit të ekspertizës teknike në pozicione specifike. Këto procese janë shoqëruar me sfida objektive, të lidhura me natyrën e specializuar të sektorit dhe kufizimet e tregut të punës. Paralelisht, Agjencia ka vijuar punën për hartimin dhe zbatimin e procedurave të brendshme, kontributin në grupet e punës për përgatitjen e akteve nënligjore, forcimin e mekanizmave të kontrollit dhe mbikëqyrjes, si dhe ndërtimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Në kuadër të bashkëpunimeve, Agjencia ka zhvilluar marrëdhënie pune me institucione kombëtare dhe ndërkombëtare, universitete dhe partnerë strategjikë, duke synuar shkëmbimin e përvojave dhe përvetësimin e praktikave më të mira europiane. Trajnimet, vizitat studimore dhe nismat inovative kanë kontribuar në ndërtimin e një qasjeje moderne për monitorimin dhe mbikëqyrjen e sektorit, të bazuar në teknologji, analiza risku dhe gjurmueshmëri.

Veprimtaria e Agjencisë lidhet ngushtë edhe me procesin e integritetit evropian të Shqipërisë, duke kontribuar në përpjekjet për përafrimin me standardet e Bashkimit Evropian, veçanërisht në fushat e sigurisë, shëndetit publik dhe forcimit të shtetit të së drejtës.

Agjencia mbetet një institucion në zhvillim, me nevojën për përmirësim të vazhdueshëm dhe konsolidim të mëtejshëm. Sfidat në vijim kërkojnë qasje të matur, transparencë dhe përgjegjësi institucionale, me synimin për të ndërtuar një sistem funksional dhe të besueshëm që garanton kontroll efektiv dhe mbrojtje të interesit publik. Vlerësoj kontributin e stafit dhe bashkëpunimin e institucioneve partnere në këtë proces, si dhe angazhimin e vazhdueshëm për përmbushjen e objektivave ligjore dhe institucionale të Agjencisë.

Misioni dhe funksionet e Agjencisë

Agjencia Kombëtare e Kontrollit të *Cannabis*-it u krijua në bazë të ligjit nr. 61/2023 “Për kontrollin e kultivimit dhe përpunimit të bimës së *cannabis*-it dhe prodhimit të nënprodukteve të saj për qëllime mjekësore dhe industriale”, si institucion publik me përgjegjësi të posaçme në mbikëqyrjen, kontrollin dhe inspektimin e aktiviteteve kultivimit dhe përpunimit të *cannabis*-it për qëllime mjekësore dhe industriale si dhe monitorimin e zbatimit të ligjit kuadër që rregullon këtë sektor.

Agjencia ka për funksion rregullimin, licencimin, monitorimin dhe mbikëqyrjen e subjekteve që ushtrojnë veprimtari në fushën e kultivimit, përpunimit, prodhimit, ruajtjes dhe qarkullimit të *cannabis*-it për qëllime mjekësore dhe industriale. Në ushtrimin e këtyre funksioneve, Agjencia kontrollon respektimin e kushteve të licencimit dhe lejimit, standardeve të sigurisë, gjurmueshmërisë, cilësisë dhe parandalimit të devijimit të nënprodukteve dhe produkteve të *cannabis*-it drejt përdorimit të paligjshëm, si dhe bashkëpunon ngushtë me institucionet ligjzbatuese dhe autoritetet e tjera shtetërore.

Misioni themelor i Agjencisë është garantimi i një sistemi të kontrolluar, të sigurt dhe transparent për zhvillimin e veprimtarive të lidhura me *cannabis*-in për qëllime mjekësore dhe industriale, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, mbrojtjen e shëndetit publik dhe interesin e përgjithshëm. Në funksion të këtij misioni, objektivat e Agjencisë janë të orientuara drejt zbatimit efektiv të legjislacionit dhe akteve nënligjore përkatëse, ngritjes dhe funksionalizimit të mekanizmave të kontrollit, monitorimit dhe mbikëqyrjes, parandalimit të devijimit të produkteve dhe nënprodukteve të *cannabis*-it drejt përdorimit të paligjshëm dhe garantimit të standardeve të sigurisë, cilësisë dhe gjurmueshmërisë përgjatë gjithë zinxhirit të veprimtarisë.

Përmbledhje ekzekutive

Gjatë vitit 2025, si një strukturë e re, Agjencia ka ndërtuar bazat institucionale të zbatimit të kuadrit të ri ligjor, duke siguruar transparencë dhe standarde të larta rregullatore.

Agjencia ka ndërmarrë hapa për ngritjen e kapaciteteve profesionale të stafit përmes pjesëmarrjes në trajnime, takime teknike dhe vizita studimore pranë strukturave dhe institucioneve homologe, përfshirë EUDA dhe INFARMED në Portugali. Këto aktivitete kanë shërbyer për njohjen me praktikat europiane në fushën rregullatore, laboratorike dhe inspektuese, si dhe për shkëmbimin e përvojës mbi mekanizmat e kontrollit dhe mbikëqyrjes.

Në fushën e projekteve kërkimore dhe inovative, Agjencia ka përgatitur dhe dorëzuar projekt-propozimin SAFEGATE në kuadër të programit Horizon Europe, me fokus në forcimin e mekanizmave të sigurisë dhe gjurmueshmërisë në zinxhirin e furnizimit të produkteve dhe nënprodukteve të *cannabis*-it. Ky angazhim përfaqëson një hap drejt përfshirjes së Agjencisë në iniciativa kërkimore bashkëpunuese në nivel evropian.

Sa i përket zhvillimit të bashkëpunimit institucional në nivel kombëtar, gjatë vitit 2025 Agjencia ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me universitete publike, me qëllim shfrytëzimin e ekspertizës akademike, teknike dhe laboratorike në mbështetje të funksioneve të kontrollit dhe monitorimit. Gjithashtu, janë vendosur linja bashkëpunimi me institucionet ligjzbatuese, veçanërisht në lidhje me proceset e verifikimit të pastërtisë së figurës dhe monitorimin e pajtueshmërisë me kërkesat ligjore, në funksion të garantimit të integritetit dhe sigurisë së proceseve të licencimit dhe mbikëqyrjes.

Në nivel ndërkombëtar, Agjencia ka marrë pjesë në aktivitete dhe forume profesionale, përfshirë takimet vjetore të CANNRA-s në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, si dhe konferenca ndërkombëtare në Europë, të fokusuara në rregullimin e sektorit të *cannabis*-it mjekësor dhe industrial. Këto pjesëmarrje kanë shërbyer për shkëmbimin e përvojave me rregullatorë dhe struktura teknike homologe, si dhe për njohjen me modele të ndryshme të organizimit dhe funksionimit të sistemeve të kontrollit dhe analizës laboratorike.

Në përfundim, viti 2025 përfaqëson një fazë zhvillimi dhe ndërtimi për Agjencinë, gjatë së cilës janë hedhur hapa të rëndësishëm për ushtrimin e funksioneve të saj.

Roli i Agjencisë në Procesin e Integritetit European

Gjatë vitit 2025, në kuadër të kompetencave të saj ligjore për kontrollin, monitorimin dhe mbikëqyrjen e sektorit të ligjshëm të *cannabis*-it për qëllime mjekësore dhe industriale, Agjencia ka kontribuar në përmbushjen e kërkesave të Kapitullit 24 - Drejtësia, Liria dhe Siguria, duke forcuar mekanizmat e parandalimit të devijimit të produkteve dhe nënprodukteve të *cannabis*-it drejt përdorimit të paligjshëm, si dhe përmes zbatimit të proceseve të verifikimit të pastërtisë së figurës për punonjësit e saj dhe për subjektet kur të fillojë procesi i licencimit dhe lejimit. Ky rol teknik dhe parandalues, i mbështetur në standarde të larta integriteti institucional dhe kontrolli të brendshëm, përbën një kontribut specifik në politikat e Bashkimit European për kontrollin e drogave, në përputhje të plotë me kompetencat dhe mandatin ligjor të Agjencisë.

Në aspektin e përafrimit me standardet e Bashkimit European, Agjencia ka ndjekur një qasje graduale përmes dhënies së kontributit dhe ekspertizës teknike në përgatitjen e akteve nënligjore, forcimit të kapaciteteve të kontrollit dhe inspektimit, përforcimit të mekanizmave të sigurisë dhe gjurmueshmërisë, si dhe mbështetjes së ngritjes së strukturave laboratorike të referencës. Këto masa, të ndërmarra brenda kompetencave ligjore të Agjencisë, kanë kontribuar në përmbushjen e detyrimeve të Shqipërisë në kuadër të Kapitullit 24 duke forcuar integritetin institucional, në përputhje me kërkesat e Bashkimit European për transparencë, siguri dhe llogaridhënie.

Kapitulli 1

ZBATIMI I KUADRIT LIGJOR DHE RREGULLATOR

1.1 Hartimi i akteve nënligjore

Ligji nr. 61/2023 parashikon autorizime ligjore për ministritë përgjegjëse për shëndetësinë, bujqësinë, rendin dhe sigurinë, ekonominë dhe financat, për propozimin e vendimeve për miratim në Këshillin e Ministrave, si dhe për nxjerrjen e udhëzimeve përkatëse në fushat e tyre të përgjegjësisë. Në këtë kuadër, Agjencia ka kontribuar në procesin e hartimit dhe koordinimit të akteve nënligjore që burojnë nga ky ligj.

Si rezultat i këtij procesi, gjatë periudhës raportuese janë miratuar 13 akte nënligjore të detyrueshme të parashikuara nga ligji nr. 61/2023. Këto akte synojnë krijimin e bazës rregullatore të nevojshme për zbatimin e ligjit, përcaktimin e procedurave institucionale dhe vendosjen e mekanizmave të kontrollit dhe mbikëqyrjes, me qëllim sigurimin e një funksionimi të kontrolluar të veprimtarisë dhe parandalimin e devijimeve drejt përdorimeve të paligjshme të produkteve dhe nënprodukteve të *cannabis*-it.

Në vijim të këtij procesi, gjatë vitit 2025 janë hartuar dhe miratuar aktet nënligjore si më poshtë:

1. VKM nr. 8, datë 09.01.2025, *“Për përcaktimin e standardeve të planit të sigurisë e të elementeve të mbrojtjes për sipërfaqen për kultivim dhe përpunim të bimës së cannabis-it për qëllime mjekësore dhe rregullave të lëvizjes së automjeteve të dedikuara të transportit të lëndëve të para dhe produkteve, që duhet të plotësojnë subjektet e licencuara”*, përcakton standardet e sigurisë dhe masat mbrojtëse që duhet të zbatohen në ambientet e kultivimit dhe përpunimit të *cannabis*-it për qëllime mjekësore nga subjektet e licencuara. Vendimi parashikon kërkesa të detajuara për sigurinë fizike të ambienteve, kontrollin e aksesit, monitorimin dhe mbikëqyrjen, si dhe rregullon lëvizjen dhe shoqërimin e mjeteve të transportit të dedikuara për lëndën e parë dhe produktet përfundimtare, me qëllim parandalimin e veprimtarive të jashtëligjshme. Gjithashtu, përcakton tarifat për shërbimet e ofruara nga shoqëritë private të sigurisë fizike dhe Illyrian Guard.
2. VKM nr. 9, datë 09.01.2025, *“Për përcaktimin e rregullave dhe tarifave për ruajtjen dhe sigurinë fizike për subjektet e lejuara”*, përcakton rregulla dhe kriteret strikte për masat e sigurisë fizike dhe mbrojtjes që duhet të përmbushen nga subjektet e lejuara, duke vendosur kërkesa rigoroze për monitorim të vazhdueshëm gjatë gjithë ciklit të kultivimit, përpunimit dhe prodhimit. Gjithashtu, ky vendim përcakton tarifat për shërbimet e ofruara nga shoqëritë private të sigurisë fizike.
3. VKM nr. 149, datë 06.03.2025, *“Për miratimin e zonave kadastrale në të cilat do të lejohet kultivimi i bimës së cannabis-it për qëllime industriale”*, miraton zonat kadastrale ku lejohet kultivimi i bimëve të *cannabis*-it për qëllime industriale. Ndër objektivat kryesore, ky akt nënligjor synon kufizimin e kultivimit vetëm në zona të përcaktuara dhe të kontrolluara, për të mundësuar mbikëqyrje, inspektim dhe

zbatim efektiv të ligjit, si dhe për të minimizuar rrezikun e veprimtarive të palejuara.

4. VKM nr. 50, datë 22.1.2025, *“Për miratimin e standardeve për zonat dhe parcelat e tokës, në të cilat do të lejohet kultivimi i bimës së cannabis-it për qëllime mjekësore dhe industriale”*, përcakton standardet dhe kriteret teknike që duhet të plotësojnë zonat dhe parcelat e tokës ku lejohet kultivimi i bimës së cannabis-it për qëllime mjekësore dhe industriale. Vendimi parashikon kërkesa mbi cilësinë dhe karakteristikat e tokës, kushtet gjeografike dhe mjedisore, distancat nga zonat e banuara dhe infrastruktura kritike, si dhe ndalimin e kultivimit në zona me rrezik mjedisor apo ndotje.
5. VKM nr. 393, datë 10.7.2025, *“Për përcaktimin e autoritetit të autorizuar për realizimin e shenjimit dhe gjurmueshmërisë”*, përcakton shoqërinë “ALBTrace CO” sh.a. si autoritetin e autorizuar për realizimin e shenjimit dhe gjurmueshmërisë së cannabis-it për qëllime mjekësore dhe industriale.
6. Udhëzimi nr.2, datë 20.01.2025, *“Për miratimin e standardeve për çdo fazë të procesit të lidhur me kultivimin e bimës së cannabis-it”*, përcakton standardet teknike dhe operacionale që duhet të zbatohen në të gjitha fazat e kultivimit, nga përgatitja e tokës dhe mbjellja, te rritja, mirëmbajtja, korrja dhe trajtimi pas korrjes. Udhëzimi synon sigurimin e praktikave të unifikuara, respektimin e kërkesave të sigurisë, cilësisë dhe gjurmueshmërisë, si dhe mundëson kontrollin dhe mbikëqyrjen efektive të procesit të kultivimit, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.
7. Udhëzimi nr.3, datë 20.01.2025, *“Për metodat e kontrollit të cilësisë, lidhur me përmbajtjen e kanabinoideve, si dhe të kontrollit fiziko-kimik dhe mikrobiologjik, për mënyrën e paketimit, formën dhe sasinë”*, parashikon përcaktimin e metodave të kontrollit të cilësisë për përmbajtjen e kanabinoideve, si dhe kryerjen e kontroleve fiziko-kimike dhe mikrobiologjike, duke rregulluar njëkohësisht mënyrën e paketimit, formën dhe sasinë e produkteve, me qëllim garantimin e sigurisë, standardizimit dhe përputhshmërisë së tyre me kriteret ligjore.
8. Udhëzimi nr.4, datë 20.01.2025, *“Për mënyrën, sasinë e marrjes së mostrave dhe laboratorin për kryerjen e analizave dhe metodat e akredituara për kontrollin e cilësisë, brenda dhe jashtë vendit”*, përcakton procedurat për marrjen e mostrave të cannabis-it, sasinë përkatëse sipas fazave të procesit, laboratorin për kryerjen e analizave, si dhe metodat e akredituara që përdoren për kontrollin e cilësisë. Udhëzimi synon garantimin e kontrollit të cilësisë, besueshmërisë së rezultateve analitike dhe përputhshmërisë me standardet në fuqi.
9. Udhëzimi nr. 5, datë 20.01.2025, *“Për mënyrën e hollësishme të asgjësimit të bimëve të cannabis-it”*, vendos procedura të detajuara për asgjësimin e bimëve të cannabis-it, duke garantuar përputhshmëri të plotë me legjislacionin në fuqi. Udhëzimi vendos kërkesa të qarta për dokumentimin, gjurmueshmërinë dhe mbikëqyrjen e procesit të asgjësimit, si dhe forcon bashkëpunimin

ndërinstitucional, duke reduktuar rrezikun e devijimit apo ripërdorimit të paligjshëm të materialeve të asgjësuar.

10. Udhëzimi nr. 10, datë 05.03.2025, *“Për përcaktimin e formatit të lejes për ushtrimin e aktiviteteve të lidhura me prodhimin e cannabis-it për qëllime industriale dhe kritereve për aktivitetet e përfshira në leje”*, përcakton formatin standard të lejes, përmbajtjen e saj dhe aktivitetet që mbulohen nga kjo leje. Udhëzimi synon qartësimin e kushteve të lejimit, unifikimin e dokumentacionit dhe sigurimin e kontrollit dhe mbikëqyrjes efektive të veprimtarive të prodhimit të cannabis-it për qëllime industriale.
11. Udhëzimi nr. 11, datë 10.03.2025, *“Për eksportin e produkteve dhe nënprodukteve përfundimtare të bimës së cannabis-it për qëllime industriale”*, rregullon eksportin e produkteve dhe nënprodukteve përfundimtare të cannabis-it për qëllime industriale, me synim garantimin e respektimit të procedurave ligjore, parandalimin e devijimit të paligjshëm dhe sigurimin që eksportet të kryhen vetëm me produkte të certifikuara drejt subjekteve të pajisura me certifikatë të vlefshme importi.
12. Rregullorja e brendshme e Agjencisë Kombëtare të Kontrollit të Cannabis-it, miratuar me urdhrin nr. 129, datë 12.03.2025, të ndryshuar, përcakton organizimin e brendshëm të Agjencisë, strukturën, funksionet dhe përgjegjësitë e njësive organizative, si dhe rregullat e funksionimit administrativ. Rregullorja synon garantimin e një ushtrimi të rregullt, transparent dhe efikas të veprimtarisë së Agjencisë, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.
13. Udhëzimi nr. 122, datë 23.7.2025, *“Për disa ndryshime dhe shtesa në Udhëzimin nr. 274, datë 16.5.2024, “Për përcaktimin e procedurave, afateve, kritereve dhe dokumentacionin e nevojshëm për verifikimin e pastërtisë së figurës të punonjësve të agjencisë kombëtare të kontrollit të cannabis-it apo të subjekteve të licencuara apo të lejuara, si dhe të kritereve etiko-profesionale”*”, synon përditësimin dhe përmirësimin e kuadrit procedural për verifikimin e integritetit dhe standardeve etiko-profesionale, duke forcuar mekanizmat e kontrollit, transparencës dhe besueshmërisë institucionale.

1.2 Zhvillimi i metodologjive të monitorimit

Gjatë vitit 2025, Agjencia ka ndërmarrë një sërë hapash për zhvillimin e metodologjive të monitorimit të veprimtarive që lidhen me kultivimin, përpunimin, transportin dhe qarkullimin e cannabis-it për qëllime mjekësore dhe industriale. Ky proces është konceptuar si një qasje e integruar, e mbështetur në përdorimin e teknologjive të avancuara, analizën e riskut dhe gjurmueshmërinë digjitale.

Agjencia ka nisur dhe po zhvillon koncepte projektesh dhe qasje metodologjike të avancuara, të orientuara drejt monitorimit inteligjent të sektorit të cannabis-it për qëllime mjekësore dhe industriale. Këto iniciativa synojnë ndërtimin e një ekosistemi të integruar mbikëqyrjeje, i cili kombinon teknologjitë e vëzhgimit ajror dhe satelitor, përdorimin e inteligjencës artificiale, analizat laboratorike të akredituara dhe mekanizma digjitalë të

gjurmueshmërisë dhe provës, me qëllim garantimin e një kontrolli të vazhdueshëm, të besueshëm dhe të bazuar në të dhëna në të gjitha fazat e aktivitetit.

Një element i rëndësishëm i këtij zhvillimi metodologjik është monitorimi në distancë i bazuar në të dhëna. Përmes përdorimit të imazherisë satelitore dhe mjeteve ajrore pa pilot (UAV/dronë), Agjencia po punon për të zhvilluar metodologji monitorimi që mundësojnë identifikimin e hershëm të zonave me risk, vlerësimin e densitetit të kultivimit, gjendjes së shëndetit të bimëve dhe devijimeve potenciale nga kushtet e licencimit dhe lejimit. Kjo qasje synon të reduktojë nevojën për inspekte fizike të shpeshta, të rrisë eficiencën në përdorimin e burimeve njerëzore dhe financiare dhe të forcojë kapacitetin parandalues dhe analitik të Agjencisë.

Paralelisht, Agjencia po punon mbi zhvillimin e koncepteve të avancuara të identifikimit dhe gjurmueshmërisë që nga burimi, përfshirë përdorimin e aplikacioneve të inteligjencës artificiale për identifikimin e farës dhe materialit gjenetik. Këto metodologji synojnë forcimin e kontrollit në pikat hyrëse të zinxhirit të furnizimit, parandalimin e futjes së materialit të paautorizuar dhe garantimin e përputhshmërisë së plotë me licencat e miratuara. Gjurmueshmëria konceptohet si një proces i pandërprerë, që shtrihet nga importi, kultivimi dhe përpunimi, deri te transporti, magazinimi, eksporti ose asgjësimi, në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi.

Gjithashtu Agjencia po punon për zhvillimin e koncepteve që mbështesin ngritjen dhe akreditimin e laboratorëve publikë sipas standardit ISO 17025, me qëllim garantimin që analizat e kanabinoideve, pesticideve dhe parametrave të tjerë të cilësisë të jenë të besueshme, të verifikueshme dhe të përdorshme si prova administrative në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Metodologjia e monitorimit konceptohet në mënyrë të tillë që rezultatet laboratorike të lidhen drejtpërdrejt me sistemet digjitale të gjurmueshmërisë dhe me zinxhirin e provës.

Një tjetër element novator i zhvillimit metodologjik është ndërtimi i zinxhirit digjital të provës (*chain of custody*), i cili synon të sigurojë integritetin e të dhënave që nga momenti i mbledhjes së informacionit deri në përdorimin e tij nga autoritetet kompetente. Kjo qasje garanton transparencë, minimizon rrezikun e manipulimit të të dhënave dhe rrit besueshmërinë e sistemit të monitorimit, duke e bërë atë të përputhshëm me standardet europiane për provat digjitale dhe me kërkesat e Kapitullit 24 të Bashkimit Europian.

Zhvillimi i këtyre koncepteve ka shërbyer si bazë për konkretizimin e angazhimit të Agjencisë në iniciativa kërkimore dhe bashkëpunuese në nivel evropian. Në këtë kuadër, një nga këto ide është formalizuar gjatë vitit 2025 përmes përgatitjes dhe paraqitjes së projektit “SAFEGATE” në thirrjen Horizon Europe, Klasteri 3: “*Better customs and supply chain security*”. Ky aplikim përfaqëson një hap të rëndësishëm në forcimin e kapaciteteve teknike dhe operacionale të Agjencisë në fushën e sigurisë, kontrollit dhe gjurmueshmërisë së *cannabis*-it për qëllime mjekësore dhe industriale, si dhe shënon

pjesëmarrjen e saj të parë si institucion publik në një konsorcium të gjerë kërkimor ndërkombëtar në kuadër të programit Horizon Europe.

Projekti është përgatitur në bashkëpunim me partnerë strategjikë europianë dhe ndërkombëtarë, duke përfshirë institucione publike, institucione kërkimore, qendra teknologjike, universitete dhe kompani të specializuara në fushën e sigurisë dhe teknologjive të avancuara nga Italia, Gjermania, Kosova, Greqia etj.

“SAFEGATE” është konceptuar si një paketë masash teknologjike dhe administrative për forcimin e kontrollit, sigurisë dhe gjurmueshmërisë së *cannabis*-it për qëllime mjekësore dhe industriale. Projekti parashikon përdorimin e pajisjeve inteligjente për kontrolle në terren, zhvillimin e një platforme digjitale të gjurmueshmërisë të ndërveprueshme me sistemet kombëtare përkatëse, si dhe aplikimin e analizës së riskut të mbështetur në inteligjencë artificiale për identifikimin e anomalive në zinxhirin e furnizimit. Projekti përfshin edhe zhvillimin e mekanizmave të standardizuar për administrimin e zinxhirit të provës, në përputhje me kërkesat ligjore dhe standardet ndërkombëtare të zbatueshme.

Kapitulli 2

PROCESI I LICENCIMIT, LEJIMIT DHE MBIKËQYRJES

2.1 Kuadri ligjor

Sa i përket procesit të licencimit, lejimit dhe mbikëqyrjes, gjatë vitit 2025, Agjencia ka qenë e angazhuar në përgatitjen dhe standardizimin e akteve të brendshme, procedurave dhe instrumenteve rregullatore zbatuese, në funksion të zbatimit të kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi. Janë hartuar procedura të brendshme dhe manuale, të cilat përcaktojnë rregullat dhe hapat kryesorë të procesit të licencimit/lejimit, si dhe parimet e ushtrimit të mbikëqyrjes, kontrollit dhe inspektimit.

Dokumentet e hartuara gjatë vitit 2025 janë konceptuar si akte përgatitore institucionale dhe pritet të miratohen në vijim në përfundim të miratimit të gjithë akteve nënligjore në zbatim të ligjit nr.61/2023. Ato synojnë të sigurojnë një proces të qartë, duke garantuar respektimin e parimeve të ligjshmërisë, transparencës, profesionalizmit dhe integritetit në ushtrimin e kompetencave të Agjencisë.

2.2 Mekanizmi i mbikëqyrjes së subjekteve

Gjatë vitit 2025, Agjencia ka vijuar përgatitjen e kuadrit procedural dhe metodologjik për ushtrimin e funksioneve të mbikëqyrjes, kontrollit dhe inspektimit, përmes hartimit të mekanizmave praktikë dhe instrumenteve mbështetëse që garantojnë zbatimin efektiv të këtyre funksioneve, në përputhje me kuadrin ligjor dhe aktet nënligjore në fuqi.

Janë konceptuar dhe projektuar paraprakisht procedurat standarde të mbikëqyrjes që mbulojnë të gjitha fazat e veprimtarisë së subjekteve, përfshirë importin, kultivimin,

korrijen, përpunimin, ruajtjen, magazinimin, transportin, asgjësimin, konfiskimin dhe eksportin.

Gjithashtu, janë parashikuar mekanizmat e monitorimit në distancë, në përputhje me kërkesat teknike të projektakteve përkatëse, duke përfshirë përdorimin e kamerave të certifikuara, sistemeve të gjurmueshmërisë dhe mjeteve të tjera teknologjike mbështetëse, si pjesë e qasjes së integruar të mbikëqyrjes.

Në vijim, janë përcaktuar paraprakisht procedurat e reagimit në rast konstatimi të shkeljeve nga autoritetet inspektuese, të cilat përfshijnë njoftimin e menjëhershëm, trajtimin administrativ të shkeljes, marrjen e masave përkatëse dhe koordinimin me institucionet ligjzbatuese, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

Në tërësi, veprimtaritë e zhvilluara gjatë vitit 2025 kanë krijuar bazën procedurale dhe metodologjike për ushtrimin e funksioneve të mbikëqyrjes dhe kontrollit mbi subjektet e licencuara dhe të lejuara, duke mundësuar zbatimin e mekanizmave përkatës në momentin e nisjes së aktivitetit të tyre.

2.3 Standardizimi i formularëve dhe dokumenteve

Gjatë vitit 2025, Agjencia ka punuar për hartimin dhe konsolidimin të formularëve dhe dokumenteve zyrtare që do të përdoren në proceset e licencimit, lejimit, autorizimit të eksportit të *cannabis*-it industrial, mbikëqyrjes, kontrollit dhe inspektimit. Ky proces ka synuar krijimin e një baze të unifikuar, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe procedurat administrative të parashikuara në ligjin nr. 61/2023.

Janë standardizuar formatet dhe përmbajtja standarde e dokumenteve administrative dhe teknike, duke siguruar qartësi procedurale, trajtim të njëtrajtshëm të informacionit dhe lehtësi në përdorim si për strukturat e Agjencisë, ashtu edhe për subjektet e licencuara apo të lejuara. Janë përgatitur modele paraprake të procesverbaleve të kontrollit, raporteve inspektuese dhe dokumenteve shoqëruese, të cilat krijojnë një bazë të qëndrueshme dokumentare për ushtrimin e veprimtarisë mbikëqyrëse, kontrolluese dhe inspektuese.

Gjithashtu, është punuar për standardizimin e dokumenteve të shkëmbimit ndërinstitucional dhe për përcaktimin e dokumentacionit që do t'u kërkohej subjekteve në çdo fazë të veprimtarisë së tyre.

Këto masa synojnë të garantojnë transparencë, siguri procedurale dhe koherencë institucionale në ushtrimin e kompetencave të Agjencisë.

Kapitulli 3

BURIMET NJERËZORE DHE VERIFIKIMI I PASTËRTISË SË FIGURËS

3.1 Plotësimi i strukturës organizative të Agjencisë

Gjatë vitit 2025, Agjencia ka vijuar funksionimin e saj institucional në përputhje me strukturën organizative të miratuar, duke u fokusuar në plotësimin gradual të kapaciteteve njerëzore të nevojshme për ushtrimin e kompetencave ligjore. Janë zhvilluar procedura rekrutimi për pozicione administrative dhe teknike, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe nevojat funksionale të institucionit.

Si rezultat i procedurave të rekrutimit të zhvilluara gjatë vitit 2025, janë emëruar 13 (trembëdhjetë) punonjës, duke e çuar numrin total të punonjësve në 20 (njëzet) në përfundim të vitit 2025. Gjatë zhvillimit të procedurave të rekrutimit është konstatuar se tregu i punës paraqet një ofertë të kufizuar të burimeve njerëzore me profile të specializuara dhe kompetenca teknike të përshtatura me kërkesat specifike të funksioneve të Agjencisë, çka ka ndikuar në kohëzgjatjen dhe kompleksitetin e proceseve të rekrutimit, në raport me nevojat që lidhen me përmbushjen efektive të misionit institucional.

Procesi i vlerësimit të performancës së punonjësve është zhvilluar në përputhje me rregulloren e brendshme të Agjencisë, duke shërbyer si bazë për monitorimin e rezultateve në punë, identifikimin e nevojave për zhvillim profesional dhe forcimin e kapaciteteve njerëzore.

3.2 Verifikimi i pastërtisë së figurës

Gjatë vitit 2025, Agjencia ka zbatuar procedurat e verifikimit të pastërtisë së figurës për kandidatët/punonjësit, në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi. Ky proces është zhvilluar në mënyrë të strukturuar dhe të dokumentuar, si pjesë e mekanizmave të brendshëm për garantimin e integritetit institucional.

Procedurat e verifikimit të pastërtisë së figurës janë kryer për 12 (dymbëdhjetë) punonjës, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, në bashkëpunim me institucionet kompetente shtetërore. Gjithashtu është vijuar administrimi i procedurave të verifikimit për punonjës të tjerë, për të cilët procesi ishte iniciuar gjatë vitit 2024.

Në funksion të unifikimit dhe rritjes së qartësisë procedurale, gjatë vitit 2025 janë standardizuar instrumentet administrative të përdorura në procesin e verifikimit, përfshirë formularët përkatës dhe praktikat shoqëruese. Gjatë zbatimit të procedurave janë evidentuar disa elemente që lidhen me afatet e kthimit të informacionit dhe harmonizimin e praktikave administrative ndërinstitutionale, të cilat kanë ndikuar në kohëzgjatjen e procesit.

Në tërësi, masat e ndërmarra gjatë vitit 2025 kanë kontribuar në forcimin e integritetit të procesit të verifikimit.

3.3 Trajnimet dhe ngritja e kapaciteteve

Trajnimi dhe ngritja e kapaciteteve profesionale të stafit kanë qenë një element thelbësor i zhvillimit të burimeve njerëzore të Agjencisë gjatë vitit 2025. Në këtë kuadër, Agjencia ka marrë pjesë në evente të rëndësishme ndërkombëtare të sektorit, të cilat kanë shërbyer si platforma për shkëmbimin e praktikave më të mira, forcimin e njohurive profesionale dhe ndërtimin e bashkëpunimeve institucionale.

Gjatë vitit 2025, Agjencia ka realizuar vizita studimore, takime zyrtare dhe shkëmbime përvojave me institucione homologe dhe aktorë ndërkombëtarë në Portugal, Gjermani dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me mbështetjen e instrumenteve ndërkombëtare si TAIEX, GIZ, si dhe fondeve të vetë Agjencisë. Këto aktivitete janë fokusuar në forcimin e kapaciteteve dhe përvetësimin e praktikave më të mira në fushën e rregullimit, licencimit, inspektimit dhe monitorimit të veprimtarive të lidhura me *cannabis*-in mjekësor dhe industrial.

Përfaqësues të Agjencisë, morën pjesë më 29-30 prill 2025 në konferencën ndërkombëtare “ICBC Berlin 2025”, një nga konferencat më të rëndësishme për industrinë e *cannabis*-it mjekësor dhe industrial në Europë. Pjesëmarrja në këtë konferencë mundësoi shkëmbimin e përvojave mbi zbatimin e standardeve ndërkombëtare, veçanërisht GMP, si dhe njohjen me zgjidhje të avancuara teknologjike për testim, monitorim dhe përmbushje të kërkesave rregullatore përgjatë zinxhirit të prodhimit.

Pjesë e rëndësishme e konferencës ishte edhe panairi i dedikuar teknologjive të avancuara, ku u prezantuan zgjidhje inovative për testim në terren dhe monitorim të bimëve nëpërmjet pajisjeve të automatizuara dhe sensorëve inteligjentë.

Gjatë vitit 2025, Agjencia ka zhvilluar një sërë aktiviteteve studimore dhe takimesh ndërkombëtare, të cilat kanë kontribuar në ngritjen e kapaciteteve institucionale, përvetësimin e praktikave më të mira dhe avancimin e njohurive teknike në fushën e kontrollit, licencimit, inspektimit dhe monitorimit të veprimtarive të lidhura me *cannabis*-in. Këto iniciativa, mbështetur edhe nga instrumenti i Bashkimit European TAIEX, kanë ofruar mundësinë e shkëmbimit të përvojave me autoritete rregullatore dhe operatorë të licencuar në shtete me eksperiencë në këtë sektor.

Një prej aktiviteteve më të rëndësishme ishte vizita studimore në Curaleaf International, një kompani ndërkombëtare e licencuar për kultivimin dhe përpunimin e *cannabis*-it mjekësor në Portugal. Gjatë kësaj vizite, delegacioni i Agjencisë pati mundësinë të ndjekë në terren çdo fazë të ciklit të kultivimit, të njohë protokollet e sigurisë, masat e mbrojtjes së objektit dhe sistemet e monitorimit të cilësisë. Kjo eksperiencë ofroi njohuri mbi zbatimin praktik të standardeve europiane GACP.

Takimi zyrtar me Agjencinë e Drogës së Bashkimit Europian (EUDA), i zhvilluar në Lisbonë me mbështetjen e TAIEX, përbën një tjetër moment të rëndësishëm në ngritjen e kapaciteteve. Në këtë takim, ku morën pjesë përfaqësues të autoriteteve shqiptare përfshirë përfaqësues nga Kryeministria, Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Ministria e Punëve të Brendshme dhe Policia e Shtetit, drejtuesit e EUDA vlerësuan angazhimin e Shqipërisë dhe shprehën gatishmërinë për mbështetje teknike dhe institucionale. Në fokus të diskutimit ishin teknologjitë e avancuara për monitorimin dhe kontrollin e sektorit, si përdorimi i dronëve dhe pajisjeve multispektrale për inspektime në terren, si dhe ndërtimi i Observatorit Kombëtar për Drogat dhe pjesëmarrja në rrjete europiane si Rrjeti i Paralajmërimit të Hershëm.

Një vizitë studimore u realizua edhe pranë Autoritetit Kombëtar për Barnat dhe Produktet Shëndetësore INFARMED në Portugali. Në këtë takim, përfaqësuesit e Agjencisë u njohën nga afër me modelin portugez të rregullimit dhe mbikëqyrjes së veprimtarive të lidhura me *cannabis*-in për qëllime mjekësore dhe industriale, duke përfshirë procedurat e licencimit, inspektimit dhe sigurimit të përputhshmërisë me standarde si GACP, GMP dhe GDP.

Vizita studimore në Institutin për Sjelljet e Varësisë (ICAD) në Lisbonë, ofroi një mundësi për të ndërtuar njohuri më të thella mbi dimensionet sociale dhe shëndetësore të përdorimit të substancave, duke përfshirë qasjet moderne të parandalimit dhe trajtimit të varësisë.

Këto takime dhe vizita studimore përfaqësojnë hapa të rëndësishëm drejt forcimit të kapaciteteve të Agjencisë në zbatim të praktikave më të mira ndërkombëtare, ndërtimit të një sistemi të besueshëm të kontrollit dhe licencimit, si dhe sigurimit të një kuadri profesional dhe institucional që garanton standarde të larta në fushën e kontrollit të *cannabis*-it mjekësor dhe industrial.

Gjithashtu, punonjësit e Agjencisë kanë marrë pjesë në konferenca dhe aktivitete të tjera ndërkombëtare, duke kontribuar në rritjen e njohurive profesionale dhe ndërtimin e rrjeteve të bashkëpunimit.

3.4 Barazia gjinore dhe mbrojtja e integritetit në vendin e punës

Gjatë vitit 2025, Agjencia ka miratuar Planin për Barazinë Gjinore 2025–2027, si dokument orientues për integrimin e parimeve të barazisë gjinore në funksionimin e saj institucional. Miratimi i këtij plani shënon një hap të rëndësishëm në konsolidimin e qasjes institucionale ndaj trajtimit të barabartë, parandalimit të diskriminimit dhe krijimit të një mjedisi pune gjithëpërfshirës.

Plani mbështetet në kuadrin ligjor kombëtar dhe detyrimet ndërkombëtare të Shqipërisë, duke përfshirë: Kushtetutën, ligjin nr. 9970/2008 “Për barazinë gjinore”, ligjin “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Kodin e Punës, Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021–2030, si dhe instrumentet ndërkombëtare (CEDAW, Konventa e Stambollit, SDG

2030, konventat e ILO-s). Në kuadër të integritetit evropian, plani harmonizohet me standardet dhe direktivat e BE-së për mundësi të barabarta dhe mosdiskriminim.

Në vijim të miratimit të planit, gjatë vitit 2025 janë ndërmarrë hapat e parë për krijimin e mekanizmave të brendshëm të nevojshëm për zbatimin e tij, përfshirë përcaktimin e përgjegjësiave për barazinë gjinore, mbledhjen e të dhënave sipas gjinisë dhe përgatitjen e procedurave për parandalimin e ngacmimit dhe diskriminimit.

Kapitulli 4

BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL

4.1 Bashkëpunimi me ministritë përgjegjëse

Gjatë vitit 2025, Agjencia ka zhvilluar bashkëpunim të vazhdueshëm me ministritë përgjegjëse, në funksion të zbatimit të ligjit nr. 61/2023 dhe ndërtimit të një sistemi të integruar licencimi, lejimi, mbikëqyrjeje dhe kontrolli për veprimtaritë e lidhura me *cannabis*-in për qëllime mjekësore dhe industriale.

Bashkëpunimi me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale gjatë vitit 2025 ka konsistuar në koordinim institucional dhe shkëmbim informacioni në kuadër të zbatimit të ligjit nr. 61/2023, si dhe në dhënien e kontributeve teknike në proceset përgatitore të akteve nënligjore dhe çështje të tjera me interes të përbashkët institucional, në përputhje me fushat përkatëse të përgjegjësisë.

Me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, bashkëpunimi gjatë vitit 2025 ka përfshirë çështje që lidhen me standardet për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor, zbatimin e praktikave të mira bujqësore (GACP), përdorimin e produkteve për mbrojtjen e bimëve, si dhe qartësimin e roleve në kontrollin e fazave të kultivimit dhe prodhimit.

Me Ministrinë e Punëve të Brendshme, bashkëpunimi gjatë vitit 2025 është fokusuar në parashikimin dhe përgatitjen e masave të sigurisë, si dhe në ndërtimin e mekanizmave të shkëmbimit të informacionit dhe bashkërendimit me strukturat ligjzbatuese.

Në tërësi, bashkëpunimi i Agjencisë me ministritë përgjegjëse ka mundësuar krijimin e mekanizmave të shkëmbimit të informacionit ndërinstitutional, duke mbështetur përgatitjen për zbatimin e qëndrueshëm të kuadrit ligjor në fuqi dhe ushtrimin efektiv të funksioneve të mbikëqyrjes dhe kontrollit në sektorin e ligjshëm të *cannabis*-it.

4.2 Bashkëpunimi me institucionet ligjzbatuese

Gjatë vitit 2025, Agjencia ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me disa institucione të cilat synojnë krijimin e mekanizmave të qëndrueshëm për shkëmbimin e informacionit, koordinimin e veprimeve operacionale dhe mbështetjen e proceseve hetimore, në funksion të integritetit institucional, sigurisë publike dhe sundimit të ligjit.

Marrëveshja me Prokurorinë e Përgjithshme

Agjencia ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Prokurorinë e Përgjithshme në vitin 2025, me qëllim forcimin e shkëmbimit të informacionit dhe koordinimit në fushën e kontrollit, inspektimit dhe monitorimit të veprimtarisë së *cannabis*-it për qëllime mjekësore dhe industriale. Marrëveshja synon garantimin e zbatimit korrekt të legjislacionit në fuqi dhe ndjekjen penale të rasteve të shkeljeve që përbëjnë vepra penale.

Bashkëpunimi përfshin shkëmbimin e informacionit mbi veprimtari të paligjshme, mbështetjen e proceseve hetimore, verifikimin e pastërtisë së figurës së punonjësve dhe subjekteve të licencuara dhe të lejuara, si dhe organizimin e aktiviteteve të përbashkëta trajnuese. Kjo marrëveshje përbën një instrument të rëndësishëm për forcimin e mekanizmave të parandalimit, hetimit dhe ndëshkimit të shkeljeve ligjore, duke kontribuar në rritjen e transparencës dhe besueshmërisë së sistemit të kontrollit.

Marrëveshja me Policinë e Shtetit

Në vitin 2025, Agjencia ka formalizuar bashkëpunimin me Policinë e Shtetit, me synim koordinimin e veprimeve për parandalimin e devijimit dhe përdorimit të paligjshëm të produkteve dhe nënprodukteve të *cannabis*-it, si dhe forcimin e mekanizmave të mbikëqyrjes, monitorimit dhe sigurisë.

Bashkëpunimi përfshin realizimin e inspektimeve dhe monitorimeve të përbashkëta, shkëmbimin në kohë reale të informacionit, mbështetjen logjistike dhe operacionale, si dhe organizimin e trajnimeve dhe aktiviteteve me interes të përbashkët. Nëpërmjet këtij partneriteti, Agjencia dhe Policia e Shtetit synojnë të sigurojnë një mjedis të ligjshëm, të kontrolluar dhe të sigurt për zhvillimin e veprimtarisë së licencuar dhe lejuar, duke parandaluar dhe goditur çdo formë të veprimtarisë së paligjshme.

Marrëveshja me Strukturën e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar

Agjencia ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Strukturën e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK), me qëllim formalizimin e bashkëpunimit institucional dhe krijimin e mekanizmave të shkëmbimit të informacionit dhe koordinimit, në përputhje me kompetencat ligjore të palëve. Marrëveshja synon të mbështesë identifikimin dhe trajtimin e rasteve me risk të lartë, në funksion të integritetit institucional, në përputhje me kompetencat ligjore të palëve.

Bashkëpunimi parashikon shkëmbimin e informacionit dhe koordinimin institucional për çështje me interes të përbashkët që lidhen me integritetin institucional dhe zbatimin e kuadrit ligjor, në përputhje me kompetencat ligjore të palëve. Nëpërmjet këtij bashkëpunimi, Agjencia kontribuon në krijimin e një kuadri të koordinuar institucional, që mbështet funksionimin e një sistemi kontrolli të besueshëm dhe transparent, në përputhje me parimet e sundimit të ligjit.

4.3 Bashkëpunimi me universitetet

Gjatë vitit 2025, Agjencia ka zhvilluar ndërveprime funksionale me institucione të arsimit të lartë, në funksion të mbështetjes së proceseve të saj rregullatore dhe mbikëqyrëse, përmes shkëmbimit të ekspertizës dhe konsultimit teknik në fusha të lidhura me veprimtarinë e saj. Këto ndërveprime kanë pasur karakter mbështetës dhe jo-strukturor, duke u orientuar drejt sigurimit të njohurive dhe inputeve teknike të nevojshme për ushtrimin e kompetencave ligjore të Agjencisë, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

Marrëveshja me Universitetin Bujqësor të Tiranës

Agjencia ka nënshkruar në vitin 2025 një marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin Bujqësor të Tiranës, me qëllim formalizimin e shkëmbimit të ekspertizës akademike dhe teknike në fusha me interes për veprimtarinë e saj.

Bashkëpunimi është orientuar drejt mbështetjes së proceseve teknike dhe shkencore që lidhen me kontrollin dhe standardizimin e praktikave përkatëse, në përputhje me kuadrin ligjor dhe standardet e aplikueshme.

Marrëveshja parashikon mundësinë e zhvillimit të aktiviteteve kërkimore dhe studimore, shkëmbimin e ekspertizës shkencore dhe organizimin e aktiviteteve edukative dhe trajnuese, në funksion të forcimit të kapaciteteve profesionale.

Marrëveshja me Universitetin e Mjekësisë, Tiranë

Në vitin 2025, Agjencia ka formalizuar bashkëpunimin me Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, me synim mbështetjen e shkëmbimit të ekspertizës akademike dhe profesionale në fusha që lidhen me veprimtarinë e saj.

Bashkëpunimi fokusohet në përmirësimin e njohurive teknike dhe shkencore që lidhen me proceset e kontrollit dhe monitorimit, si dhe në zhvillimin e aktiviteteve kërkimore dhe edukative, në përputhje me kuadrin ligjor dhe standardet përkatëse.

Marrëveshja parashikon zhvillimin e projekteve studimore, organizimin e trajnimeve profesionale dhe shkëmbimin e informacionit mbi praktikat bashkëkohore.

Marrëveshja me Universitetin e Tiranës

Agjencia ka nënshkruar në vitin 2025 një marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin e Tiranës, me qëllim shkëmbimin e ekspertizës shkencore dhe mbështetjen e zhvillimit të kapaciteteve profesionale në fusha me interes për veprimtarinë e saj. Bashkëpunimi synon thellimin e njohurive dhe praktikave teknike që lidhen me kontrollin, kultivimin, përpunimin dhe prodhimin e bimës së *cannabis*-it, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

Bashkëpunimi parashikon zhvillimin e aktiviteteve kërkimore dhe trajnuese, si dhe shkëmbimin e njohurive dhe përvojës akademike, në funksion të përmirësimit të praktikave profesionale dhe mbështetjes së proceseve rregullatore.

Marrëveshja me Universitetin Politeknik të Tiranës

Agjencia ka formalizuar një marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin Politeknik të Tiranës, me synim mbështetjen e zhvillimeve teknike dhe shkencore që lidhen me ushtrimin e kompetencave të saj mbikëqyrëse dhe kontrolluese.

Në kuadër të kësaj marrëveshjeje, Universiteti Politeknik i Tiranës ka zhvilluar një aktivitet kërkimor të financuar nga Agjencia Kombëtare për Kërkimin Shkencor dhe Inovacionin (AKKSHI), në cilësinë e institucionit zbatues. Roli i Agjencisë ka qenë koordinues dhe mbështetës, përmes ofrimit të inputeve institucionale dhe ndjekjes së ecurisë së aktivitetit, në përputhje me objektivat e përcaktuara. Aktiviteti ka pasur karakter eksplorues dhe metodologjik, duke u fokusuar në analizimin e përdorimit të teknologjive digjitale për qëllime monitorimi dhe kontrolli, pa krijuar detyrime operationale apo strukturore për Agjencinë.

Në përgjithësi, gjatë vitit 2025, Agjencia ka ndërvepruar me institucione të arsimit të lartë në mënyrë funksionale dhe jo-strukturore, përmes shkëmbimit të ekspertizës dhe konsultimit teknik, në funksion të mbështetjes së proceseve rregullatore dhe mbikëqyrëse.

Këto ndërveprime janë konceptuar si instrumente mbështetëse me karakter të kufizuar në kohë dhe objekt, duke synuar adresimin e nevojave konkrete teknike dhe rregullatore, pa cënuar rolin qendror të Agjencisë në proceset vendimmarrëse dhe pa krijuar varësi funksionale nga aktorë të jashtëm, në përputhje me interesin publik dhe parimet e administratës shtetërore.

4.4 Projekte

Me synim forcimin e kapaciteteve institucionale në përmbushje të misionit të saj sipas ligjit nr. 61/2023 dhe në funksion të procesit të raportimit për Kapitullin 24, Agjencia aplikoi në nëntor 2024 në platformën TAIEX të Komisionit European për mbështetje teknike dhe institucionale. Mbështetja u konfirmua zyrtarisht më 5 shkurt 2025 dhe, nga gjashtë aktivitetet e propozuara fillimisht, katër u miratuan për zbatim.

Qëllimi i projektit është ngritja e kapaciteteve dhe përmirësimi i koordinimit ndërinstitutional në fushën e licencimit, mbikëqyrjes dhe kontrollit të veprimtarive të lidhura me *cannabis*-in mjekësor dhe industrial, në përputhje me standardet dhe praktikën më të mira të Bashkimit European (GACP, GMP, GDP). Projekti synon gjithashtu përafrimin e procedurave kombëtare me standardet e BE-së, përvetësimin e praktikave më të mira europiane dhe forcimin e bashkëpunimit kombëtar dhe ndërkombëtar në këtë sektor të ri të vendit tonë.

Si pjesë e projektit, gjatë vitit 2025 u realizua një vizitë studimore në Portugali (maj 2025), me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të nivelit të lartë nga Agjencia, ministritë përgjegjëse dhe institucionet ligjzbatuese. Vizita u fokusua në modelin portugez të rregullimit të *cannabis-it* mjekësor dhe industrial, mekanizmat e koordinimit institucional, praktikat e eksportit, si dhe rolin e EUDA dhe Observatorit Kombëtar të Drogave në mbledhjen dhe analizën e të dhënave.

Në vijim të zbatimit të projektit, mbeten për t'u organizuar tre aktivitete të miratuara: një mision ekspertësh për ngritjen e kapaciteteve në fushat e politikave, shëndetit publik, menaxhimit të riskut, sigurisë dhe mbikëqyrjes; një vizitë studimore në Itali me fokus në praktikat e licencimit, standardet GACP, GMP dhe GDP, kontrollin e cilësisë dhe sistemet e gjurmueshmërisë; si dhe një workshop mbi ndikimin ekonomik dhe social të industrisë së *cannabis-it* në Shqipëri, përfshirë zhvillimin rural, punësimin, eksportet dhe komunikimin publik. Institucionet që përfitojnë drejtpërdrejt nga ky projekt përfshijnë Agjencinë Kombëtare të Kontrollit të *Cannabis-it*, Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Ministrinë e Punëve të Brendshme, Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Institutin e Shëndetit Publik, Policinë e Shtetit dhe institucione të tjera të përfshira në zbatimin e ligjit nr. 61/2023.

Kapitulli 5

BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

5.1 Aktiviteti i Agjencisë në kuadër të anëtarësimit në CANNRA

Gjatë vitit 2025, punonjës të Agjencisë morën pjesë në një seri takimesh dhe seminaresh online të nënkomiteteve të CANNRA-s (Cannabis Regulators Association), të fokusuara në trajtimin e sfidave që lidhen me kultivimin, prodhimin dhe gjurmueshmërinë e *cannabis-it* mjekësor dhe industrial. Diskutimet u përqendruan në analizimin dhe krahasimin e qasjeve institucionale dhe operacionale, veçanërisht në çështje që lidhen me pajtueshmërinë, zbatimin e ligjit, sistemet e gjurmimit dhe qartësimin e ndarjes ndërmjet inspektimeve administrative dhe hetimeve penale. Një vëmendje e veçantë iu kushtua parandalimit të mashtrimeve në testimet laboratorike, përfshirë integritetin e të dhënave dhe përfaqësueshmërinë e mostrave, si dhe çështjeve që lidhen me mbrojtjen e shëndetit publik dhe standardet e paketimit dhe etiketimit. Në këtë kuadër, Agjencia u fokusua në përvetësimin e praktikave më të mira ndërkombëtare për ngritjen e kapaciteteve laboratorike dhe zhvillimin e sistemeve të gjurmueshmërisë, duke shqyrtuar gjithashtu përdorimin e mjeteve orientuese për testime paraprake në terren, pa zëvendësuar analizat zyrtare të laboratorëve të akredituar.

Takimi vjetor i CANNRA-s, i zhvilluar në Atlanta, Georgia, në datat 8-10 dhjetor 2025, shërbeu si forum ndërkombëtar shkëmbimi për autoritete rregullatore dhe institucione homologe nga Shtetet e Bashkuara dhe vende të tjera, përfshirë Kanadanë, Holandën,

Maltën dhe Shqipërinë. Diskutimet u përqendruan në çështje të pajtueshmërisë rregullatore, mbrojtjes së shëndetit publik dhe menaxhimit të burimeve institucionale, duke krijuar gjithashtu mundësi për ndërtimin e kontakteve profesionale dhe shkëmbimin e përvojave mbi praktikën e inspektimit, testimit dhe gjurmueshmërisë.

5.2 Marrëdhëniet me organizata ndërkombëtare

Gjatë vitit 2025, Agjencia ka zhvilluar dhe konsoliduar marrëdhënie bashkëpunimi me organizata ndërkombëtare në fushën e politikave të drogës, mbikëqyrjes institucionale dhe ndërtimit të kapaciteteve, në funksion të ushtrimit të kompetencave të saj dhe përmbushjes së detyrimeve që rrjedhin nga ligji nr. 61/2023.

Bashkëpunimi me Agjencinë Europiane të Drogës (EUDA) dhe me programin GPDPD, të mbështetur nga GIZ, është fokusuar në përafrimin e praktikave kombëtare me standardet e Bashkimit Europian, forcimin e koordinimit ndërinstitutional dhe sigurimin e mbështetjes teknike për zbatimin efektiv të kuadrit ligjor, në linjë me objektivat e procesit të integritetit evropian.

Pjesëmarrja e Agjencisë në seminarin “Politikat e Drogës në Shqipëri”, organizuar nga GIZ/GPDPD në bashkëpunim me partnerë vendas dhe ndërkombëtarë, përbën një moment të rëndësishëm shkëmbimi ndërinstitutional dhe ndërkombëtar. Ky aktivitet shërbeu për diskutimin e kuadrit strategjik kombëtar të politikave të drogës, analizimin e praktikave ekzistuese dhe identifikimin e fushave prioritare për mbështetje të mëtejshme ndërkombëtare, ku Agjencia u përfshi aktivisht në cilësinë e institucionit përgjegjës për mbikëqyrjen dhe kontrollin e sektorit të *cannabis*-it mjekësor dhe industrial.

Në vijim të këtij bashkëpunimi, ndërveprimi me Agjencinë Europiane të Drogës (EUDA) është përqendruar në forcimin e mekanizmave të analizës së politikave të drogës, shkëmbimin e të dhënave dhe ndërtimin e një kornize të qartë bashkëpunimi ndërinstitutional. Ekspertiza e EUDA-s ka kontribuar në prezantimin e modeleve evropiane të koordinimit, duke theksuar rëndësinë e roleve të qarta institucionale, funksionimit të sistemeve të informacionit dhe përdorimit të të dhënave të strukturuar për mbështetjen e proceseve të monitorimit dhe mbikëqyrjes.

Nëpërmjet programit GPDPD, të mbështetur nga GIZ, bashkëpunimi është përqendruar në mbështetjen e koordinimit ndërinstitutional, ngritjen e kapaciteteve profesionale dhe përmirësimin e qasjeve institucionale në fushën e politikave të drogës. GIZ ka shërbyer si platformë ndërmjetësuese për dialogun mes institucioneve kombëtare dhe partnerëve ndërkombëtarë, duke mbështetur shkëmbimin e përvojave.

Gjatë vitit 2025, Agjencia ka mbajtur komunikim të rregullt dhe bashkëpunim teknik me European Industrial Hemp Association (EIHA), në funksion të shkëmbimit të ekspertizës dhe ndjekjes së zhvillimeve ndërkombëtare që lidhen me *cannabis*-in industrial. Ky bashkëpunim ka shërbyer për informimin mbi praktikën dhe standardet teknike të aplikuara

në nivel evropian, si dhe për ndjekjen e diskutimeve që lidhen me prodhimin, përpunimin dhe tregtimin e produkteve të *cannabis*-it industrial.

Agjencia ka zhvilluar takim informativ me Food and Drug Administration (FDA), të fokusuar në diskutimin e parashikimeve ligjore të ligjit nr. 61/2023 dhe në njohjen me praktikatat rregullatore dhe institucionale të aplikuara në Shtetet e Bashkuara. Ky takim shërbeu për shkëmbimin e informacionit mbi qasjet ligjore dhe administrative, në funksion të kuptimit të modeleve të ndryshme të zbatimit të legjislacionit në këtë fushë.

Agjencia gjithashtu mban marrëdhënie me International Narcotics Control Board (INCB), në funksion të garantimit të përputhshmërisë me detyrimet ndërkombëtare dhe sigurimit të një raportimi të rregullt dhe të saktë institucional.

Në tërësi, bashkëpunimet e zhvilluara gjatë vitit 2025 kanë kontribuar në identifikimin e nevojave konkrete për mbështetje teknike dhe institucionale, veçanërisht në drejtim të përmirësimit të sistemeve të informacionit, shkëmbimit të të dhënave dhe forcimit të kapaciteteve profesionale të Agjencisë. Këto marrëdhënie përbëjnë një mbështetje të rëndësishme për ushtrimin efektiv të funksioneve të Agjencisë në një sektor të ri dhe kompleks, duke mundësuar akses në ekspertizë të specializuar dhe përvojë ndërkombëtare.

5.3 Marrëdhëniet me Delegacionin e Bashkimit Evropian në Shqipëri

Gjatë vitit 2025, Agjencia ka ruajtur marrëdhënie bashkëpunimi dhe komunikim të vazhdueshëm me përfaqësues të Delegacionit të Bashkimit Evropian në Shqipëri. Ky komunikim ka shërbyer për të siguruar transparencë mbi qasjet institucionale të ndjekura, progresin e ndërmarrë dhe sfidat e identifikuar në zbatimin e kuadrit ligjor në fuqi, në kontekstin e angazhimeve të Shqipërisë në procesin e integritetit evropian.

Kapitulli 6

MENAXHIMI FINANCIAR, PROKURIMI PUBLIK DHE KONTROLLI I BRENDSHËM

6.1 Procedurat e Prokurimit Publik

Agjencia është përgjegjëse për administrimin dhe menaxhimin e fondeve publike të destinuara për prokurimet publike, në përputhje me ligjin nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, Vendimin nr. 285, datë 19.05.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, si dhe udhëzimet e Agjencisë së Prokurimit Publik (APP), të nxjerra në bazë dhe për zbatim të këtij ligji.

Në funksion të ushtrimit korrekt të kompetencave në fushën e prokurimit publik, gjatë vitit 2025 Agjencia ka ngritur dhe vënë në funksion strukturat përgjegjëse për procedurat e prokurimit me vlerë të vogël, përmes miratimit të akteve të brendshme administrative, duke

përcaktuar personat përgjegjës, komisionet përkatëse dhe mekanizmat e nevojshëm për zhvillimin e procedurave të prokurimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Në zbatim të nenit 16 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, si dhe të kuadrit ligjor për prokurimin publik, gjatë vitit 2025 është miratuar dokumenti “Gjurma e auditimit për procedurat e prokurimeve me vlerë të vogël dhe procedurat e prokurimit deri në vlerën 100.000 lekë në Agjencinë Kombëtare të Kontrollit të *Cannabis-it*”. Ky dokument përcakton procedurat e unifikuara të ndjekura nga Agjencia dhe siguron dokumentimin e plotë të operacioneve, duke garantuar transparencë dhe një mjedis të qartë kontrolli për audituesit e brendshëm, audituesit e jashtëm dhe autoritetet mbikëqyrëse.

Agjencia administron dhe ruan dokumentacionin e plotë për çdo procedurë prokurimi, që nga faza e planifikimit deri në zbatimin dhe përfundimin e kontratës, duke siguruar përputhshmëri me kërkesat ligjore dhe rregullatore, si dhe transparencë në përdorimin e fondeve publike.

6.2 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Gjatë vitit 2025, Agjencia ka ushtruar funksionet e saj në fushën e menaxhimit financiar në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe udhëzimet e institucioneve përgjegjëse. Në këtë kuadër, janë përgatitur dhe përcjellë pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale kërkesat buxhetore për periudhën afatmesme 2026-2028, në zbatim të procedurave për hartimin e buxhetit dhe planifikimin afatmesëm.

Agjencia ka kryer monitorimin periodik të zbatimit të buxhetit, përfshirë raportimin e të dhënave financiare për periudhën janar-gusht 2025, në përputhje me udhëzimet standarde të Ministrisë së Financave. Gjithashtu, gjatë vitit raportues janë ndjekur procedurat për rishpërndarjen e fondeve të miratuara për vitin 2025, në përputhje me nevojat operacionale të institucionit.

Kapitulli 7

KOMUNIKIMI DHE TRANSPARENCA ME PUBLIKUN

7.1 Platformat zyrtare të komunikimit dhe informimit publik

Gjatë vitit 2025, Agjencia ka administruar platformat zyrtare të komunikimit dhe informimit publik, të cilat shërbejnë për garantimin e transparencës, aksesit në informacion dhe ndërveprimin me publikun. Në këtë kuadër, faja zyrtare e Agjencisë www.nacc.gov.al përbën kanalin kryesor të informimit zyrtar, e mbështetur edhe nga përdorimi i rrjeteve sociale Facebook dhe LinkedIn për shpërndarjen e informacionit institucional dhe orientimin e publikut drejt burimeve zyrtare.

Në faqen zyrtare janë pasqyruar në mënyrë të strukturuar informacionet mbi veprimtarinë institucionale, aktet nënligjore në zbatim të ligjit nr. 61/2023 dhe bashkëpunimet në të cilat Agjencia është e angazhuar, si dhe njoftimet për vendet vakante. Gjithashtu, faja përmban lidhje funksionale për paraqitjen e kërkesave për informacion dhe kërkesave për takim, të shoqëruara me të dhënat përkatëse dhe elementët e nevojshëm për identifikimin dhe komunikimin me kërkuesit, në përputhje me kuadrin ligjor për të drejtën e informimit. Faqa zyrtare ka shërbyer gjithashtu për publikimin e njoftimeve për vendet vakante, në përputhje me procedurat ligjore në fuqi për plotësimin e strukturës së Agjencisë.

Një element i rëndësishëm ka qenë administrimi dhe përditësimi i Programit të Transparencës, i hartuar në përputhje me ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, të ndryshuar. Programi është ristrukturuar me synimin për të përmirësuar aksesin në informacion zyrtar, për të siguruar publikimin proaktiv të dokumenteve të detyrueshme dhe për të lehtësuar orientimin e qytetarëve dhe subjekteve të interesuara në gjetjen e informacionit përkatës.

7.2 Komunikimi me publikun

Gjatë vitit 2025, pranë Agjencisë janë administruar kërkesa për informacion, të cilat janë trajtuar në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” dhe brenda afateve ligjore të përcaktuara.

Kërkesat e adresuara kanë pasur kryesisht si objekt ecurinë e kuadrit ligjor dhe nënligjor për *cannabis*-in mjekësor dhe industrial, fazën aktuale të zhvillimit të këtij sektori, si dhe informacion mbi procedurat dhe mekanizmat e parashikuar për mbikëqyrjen dhe kontrollin institucional.

Një pjesë e kërkesave ka pasur në fokus aspektet që lidhen me monitorimin dhe kontrollin e veprimtarive të lejuara, kriteret e eksportit dhe tregjet potenciale, si dhe mënyrat e informimit publik për zhvillimet në këtë fushë përmes kanaleve zyrtare të komunikimit.

Kapitulli 8 **OBJEKTIVAT PËR VITIN 2026**

8.1 Zbatimi i kuadrit ligjor dhe rregullator

Agjencia do të fokusohet në konsolidimin e kuadrit ligjor që rregullon veprimtarinë e saj, në funksion të ushtrimit të kompetencave të përcaktuara nga ligji nr. 61/2023. Prioritet do të jetë finalizimi i manualeve të proceseve të punës dhe udhëzimeve teknike, si dhe sigurimi i një qasjeje të unifikuar procedurale në të gjitha funksionet e Agjencisë. Këto veprime synojnë garantimin e qartësisë, standardizimit dhe zbatimit të njëtrajtshëm të legjislacionit në të gjitha fazat e veprimtarisë së mbikëqyrjes, kontrollit dhe inspektimit.

8.2 Procesi i licencimit, lejimit dhe mbikëqyrjes

Agjencia do të angazhohet në ushtrimin e plotë të rolit të saj në procesin e licencimit dhe lejimit të subjekteve, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe kompetencat e përcaktuara. Veprimtaria e Agjencisë do të fokusohet në mbështetjen e Komisionit të Licencave dhe ministrisë përgjegjëse për bujqësinë gjatë shqyrtimit të aplikimeve, me qëllim garantimin e respektimit të kriterëve ligjore dhe teknike, transparencës procedurale dhe trajtimit të barabartë të aplikantëve. Në vijim, do të ushtrohen funksionet mbikëqyrëse për monitorimin e veprimtarisë së subjekteve të licencuara dhe të lejuara, me fokus në respektimin e masave të sigurisë, kushteve të licencimit dhe standardeve përkatëse. Gjatë ushtrimit të këtyre funksioneve do të përdoren formularët, dokumentet tip dhe procedurat e standardizuara të raportimit, si dhe do të sigurohet informim i qartë dhe i përditësuar për publikun përmes kanaleve zyrtare të komunikimit.

8.3 Burimet njerëzore dhe verifikimi i pastërtisë së figurës

Agjencia do të vijojë forcimin e kapaciteteve të saj njerëzore dhe institucionale, përmes plotësimit të strukturës organizative dhe zhvillimit profesional të stafit. Objektivi mbetet rekrutimi i punonjësve të kualifikuar dhe të specializuar, në funksion të garantimit të një funksionimi normal dhe efikas të Agjencisë. Mbetet prioritet zbatimi i procedurave për verifikimin e pastërtisë së figurës, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, si një element thelbësor për garantimin e integritetit institucional dhe besueshmërisë së veprimtarisë së Agjencisë.

Një vëmendje e veçantë do t'i kushtohet trajnimeve të specializuara në fusha që lidhen me mbikëqyrjen, kontrollin, verifikimin e pastërtisë së figurës, administrimin e të dhënave sensitive dhe standardet e sigurisë. Këto masa synojnë rritjen e cilësisë së ushtrimit të funksioneve ligjore të Agjencisë.

8.4 Bashkëpunimi ndërinstitucional

Në vitin 2026, Agjencia synon konsolidimin e bashkëpunimit ndërinstitucional për mbështetjen e proceseve të licencimit, lejimit, mbikëqyrjes, kontrollit dhe inspektimit. Objektivat përfshijnë përmirësimin e koordinimit me institucionet ligjzbatuese, rritjen e shkëmbimit të informacionit dhe zhvillimin e mekanizmave të rregullt të bashkërendimit për harmonizimin e procedurave dhe veprimeve mbikëqyrëse.

Agjencia do të vijojë gjithashtu bashkëpunimin me ministritë dhe institucionet e tjera publike, si dhe do të mbështesë iniciativë të përbashkëta për transformimin social dhe ekonomik të zonave me histori kultivimi informal, duke orientuar zhvillimin drejt praktikave të ligjshme, të kontrolluara dhe të certifikuara.

8.5 Bashkëpunimi ndërkombëtar

Në planin ndërkombëtar, Agjencia synon vijimin dhe konsolidimin e përfshirjes së saj në rrjete dhe forume ndërkombëtare relevante për fushën e *cannabis*-it mjekësor dhe industrial. Në këtë kuadër, do të vijojë pjesëmarrja në aktivitetet me fokus përfitimin e asistencës teknike, shkëmbimin e përvojave dhe praktikave më të mira, si dhe ndjekjen e zhvillimeve rregullatore dhe teknike në këtë sektor.

Gjithashtu, Agjencia synon vijimin e pjesëmarrjes në konferenca dhe forume ndërkombëtare, me qëllim forcimin e bashkëpunimit me rregullatorë, institucione teknike dhe aktorë të tjerë ndërkombëtarë, si dhe ndjekjen e standardeve dhe praktikave bashkëkohore.

8.6 Kërkimi shkencor dhe inovacioni

Në fushën e kërkimit shkencor dhe inovacionit, Agjencia synon ndjekjen, koordinimin dhe mbështetjen e zbatimit të projekteve potenciale që lidhen drejtpërdrejt me fushën e veprimtarisë së saj, si dhe forcimin e bashkëpunimit institucional me universitetet dhe institucionet akademike, me qëllim promovimin e kërkimit shkencor, transferimin e njohurive dhe zhvillimin e kapaciteteve profesionale në sektorët përkatës.

Prioritet mbetet realizimi i aktiviteteve të planifikuara në kuadër të asistencës TAIEX, si dhe vijimi i mbështetjes institucionale për iniciativa dhe projekte që lidhen me forcimin e mekanizmave të kontrollit, sigurisë dhe gjurmueshmërisë.

Agjencia synon gjithashtu përfshirjen në projekte kërkimore dhe inovative të financuara nga programe të Bashkimit Europian. Do të ndiqet zhvillimi dhe zbatimi i projekteve në përputhje me objektivat dhe fushën e përgjegjësisë institucionale të Agjencisë.

8.7 Komunikimi dhe transparenca me publikun

Në vitin 2026, Agjencia synon vijimin e politikave të transparencës dhe komunikimit publik, me qëllim sigurimin e informimit të qartë, të strukturuar dhe të aksesueshëm për qytetarët dhe subjektet e interesuara. Objektivat përfshijnë administrimin dhe përditësimin e rregullt të faqes zyrtare, publikimin proaktiv të dokumentacionit rregullator dhe udhëzues, si dhe ofrimin e informacionit dhe asistencës institucionale për subjektet potenciale, përpara dhe gjatë fazës së aplikimit, përmes kanaleve zyrtare të komunikimit.